



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E  
PROJEKTEVE STRATEGJIKE  
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS  
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 15427 Prot.

Lezhë, më 23 /09 /2022

V E N D I M

Nr. 446 Datë 23/09 /2022

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT PËR  
PROJEKT-PROPOZIMET E MARRA NË DORËZIM NË BAZË TË THIRRJES SË  
KATËRT PUBLIKE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË  
BASHKINË LEZHË PËR VITIN 2022**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.1 shkronja (b), Vendimi Nr.393 Date 18.07.2022 “ Per miratimin e Rregullores mbi Organizimin, Funksonimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administrates se Bashkise Lezhe ", VKB Nr. 211 datë 31/10/2017 “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmejt Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Bashkisë Lezhë si dhe miratimin e metodologjisë për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile” pika 2. “Të miratohet Metodologjia LOD për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile, të propozuar nga UNDP dhe të miratuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë”; “Memorandumi i Mirëkuptimit Ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Lezhë” Nr. Prot 17007 datë 22.09.2021.

V E N D O S I :

**NENI I**

Përfaqësuesit e mëposhtëm të Bashkisë Lezhë caktohen si anëtarë të Komisionit të Vlerësimit për projekt-propozimet e marra në dorëzim në bazë të Thirrjes së Katërt Publike të Programit Reload Të Financuar nga Bashkia Lezhë për Organizatën e Shoqërisë Civile për vitin 2022.

1. **Elson FRROKU** – Drejtor, në drejtorinë e Projekteve Strategjike Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës.
2. **Altin LLESHI** – Keshilltar Juridik, Kabineti i Kryetarit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA LEZHË**

**NENI II**

Ky anëtar do të jetë pjesë e Komisionit të Vlerësimit me tre anëtarë, i cili është përfaqësues nga shoqëria civile, i zgjedhur me thirrje të hapur me Vendimin **Nr 442 Datë 20/09/2022**:

1. **Ardeta KOÇI** - Përfaqësues i shoqërisë civile

**NENI III**

Komisioni i Vlerësimit është organi përgjegjës për vlerësimin e projekt-propozimeve. Të gjithë anëtarët e Komisionit kanë të drejta dhe përgjegjësi të barabarta. Komisioni ka për detyrë të vlerësojë të gjitha projekt-propozimet e marra në bazë të Thirrjes së Katërt Publike të Programit Reload të financuar nga Bashkia Lezhë për Organizatën e Shoqërisë Civile. Komisioni propozon projektet që do financohen brenda fondeve të disponueshme për thirrjen publike, sipas Udhëzimeve të miratuara.

**NENI IV**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I dërgohet:

1. Personave të emëruar;
2. Arkivit.

**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**

